

Gjykata Supreme e Kosovës

Ap. – Kž. – 364/2010

12 prill 2011

Prishtinë


NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar kolegji, gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia dhe gjyqtari i EULEX-it Charles L. Smith III, gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtare të kolegjit, të asistuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Sampsa Hakala si procesmbajtës,

në procedurën penale kundër:

Avni Osmanit, , data e lindjes , vendi i lindjes: fshati , Komuna e , me banim në të njëjtin vend, emri i të atit , emri i vajzërisë së nënës , i , , ka të kryer shkollën e , me gjendje të mesme ekonomike, me , mbahet në paraburgim që nga 29 tetori 2004, i dënuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës për veprën penale **Vrasje e Rëndë** në pajtim me nenin 147 paragrafi 1 pikat 3 dhe 8 të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

Duke vendosur mbi ankesat e të pandehurit Avni Osmani, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit Publik të Qarkut, të gjitha të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P.nr. 64/2005, të datës 30 nëntor 2009,



pas pranimit të mendimit dhe propozimit nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) të datës 14 tetor 2010,

pas seancës së hapur të kolegjit të mbajtur me 12 prill 2011, në praninë e Prokurorit të Shtetit Laura Pula, të pandehurit Avni Osmani dhe avokatit të tij mbrojtës Feti Limani,


më 12 prill 2011, në pajtim me nenet 392 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), publikisht shqipton këtë:

AKTGJYKIM

Përmes kësaj REFUZOHEN ankesat e të pandehurit Avni Osmani dhe avokatit të tij mbrojtës kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P.nr. 64/2005, të datës 30 nëntor 2009.

Përmes kësaj REFUZOHET ankesa e Prokurorit të Qarkut kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P.nr. 64/2005, të datës 30 nëntor 2009.

VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P.nr. 64/2005, të datës 30 nëntor 2009.



ARSYETIMI

I Historia e Procedurës

Aktakuza kundër të pandehurit është paraqitur nga Prokurori Publik vendor në Prishtinë më 26 tetor 2005 duke e akuzuar Avni Osmanin për veprën penale Vrasje e Rëndë në pajtim me nenin 147 paragrafi 1 pikat 3 dhe 8 të Kodit Penal të Kosovës. Aktakuza ishte konfirmuar dhe shqyrtimi kryesor kundër të pandehurit filloi më 20 mars 2006 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës para kolegjit të përbërë nga gjyqtarët vendor dhe gjyqtarët porotë. Trupi gjykues mbajti seanca të shumta por nuk ishte në gjendje të kompletoj gjykimin deri më 24 prill 2009, kur Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it vendosi t'i caktoj këtë lëndë kolegjit të përbërë në shumicë nga gjyqtarët e EULEX-it. Kolegji i gjyqtarëve ndërkombëtar ishte kërkuar nga i pandehuri dhe kërkesa formalisht ishte vërtetuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut.

Akuza penale kundër Avni Osmanit është e lidhur me vrasjen e Kastriot Zogianit më 28 tetor 2004. Sipas akuzës krimi kishte ndodhur në fshatin Bardhë i Madh, komuna e Fushë Kosovës, ku me sa duket i pandehuri e ka qëlluar për vdekje viktimën me revole të kalibrit 9x19 mm. Pas vrasjes trupi i viktimës ishte vendosur në një grope në tokë dhe ishte mbuluar me lëndë plastike dhe që ishte bërë nga i pandehuri me ndihmën e një Fitim Breznica i cili prandaj u dënua në të njëjtën procedure për veprën penale të dhënies ndihmë të kryerësit të krimit pas përfundimit të veprës penale.

Gjykimi i shkallës së parë pastaj ka ri-filluar më 4 qershor 2009 para një kolegji të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Gjatë procedurës ndjekja penale është përfaqësuar nga Prokurori Publik vendor.

Shqyrtimi kryesor kundër të pandehurit ishte kompletuar më tej në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës në fund të nëntorit 2009. Të gjitha palët ishin të pranishme në gjykim. Më 30 nëntor 2009 Gjykata e Qarkut shqiptoi aktgjykimin e saj duke e shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale me të cilën akuzohet dhe duke e dënuar me 30 vite burgim.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte dorëzuar në Prokurorinë e Qarkut më 23 shtator 2010 dhe të pandehurit Avni Osmani personalisht më 29 shtator 2010. Ankesat kundër këtij aktgjykimi ishin paraqitur nga personat e mëposhtëm: Prokurori i Qarkut të Prishtinës, avokati mbrojtës Fadil Hoxha dhe i pandehuri më 27 shtator 2010, respektivisht 6 tetor 2010 dhe 12 tetor 2010.


ZPSHK ka parashtruar një mendim dhe propozim për ankesën. Prokurori i Shtetit në mendimin dhe propozimin e tij argumenton se ankesat e paraqitura në emër të pandehurit janë të pabazuara, e në këtë mënyrë e shtynë Gjykatën Supreme ta refuzoj atë megjithatë Prokurori i Shtetit propozon të pranohet ankesa e Prokurorit të Qarkut dhe e shtynë Gjykatën Supreme të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të shqiptoj një dënim të më rëndë mbi të pandehurin.

Gjatës caktimit të kësaj seance ish avokati mbrojtës i të pandehurit Avni Osmani, z. Fadil Hoxha e njoftoj Gjykatën Supreme se ai është tërhequr nga detyra e avokatit mbrojtës për Avni Osmanin. Sipas ligjit të procedurës penale në këtë lëndë i pandehuri patjetër duhet të ketë mbrojtës për shkak të peshës së veprës penale me të cilën akuzohet. Prandaj më 14 mars 2011 Kryetari i kolegjit emëroi ex officio një avokati mbrojtës tjetër për të pandehurin. Avokati Feti Limani nga Prishtina ishte caktuar si avokat mbrojtës në pajtim me pëlqimin e tij.

II Gjetjet e Gjykatës Supreme

Të gjitha ankesat janë paraqitur në kohë dhe janë të pranueshme.

Megjithatë Gjykata Supreme konstaton se ankesat janë të pabazuara.



Ankesat në dobi të mbrojtjes ishin paraqitur mbi katër baza: 1) Shkelja e rregullave të procedurës penale; 2) Shkelja e ligjit penal; 3) Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike; dhe 4) vendimi mbi sanksionet penale.

Prokurori i Qarkut, me ankesën e tij ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së qarkut mbi dënimin dhe propozon të rritet dënimi ndaj të pandehurit Avni Osmani.

1) Mbrojtja fakton se aktgjykimi i gjykatës së qarkut përmban disa shkelje të procedurës penale përkatësisht të Nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së. Si pikë e parë u kundërshtua se gjykata e qarkut nuk ka ofruar arsyetim rreth fakteve vendimtare të lëndës. Gjykata Supreme, megjithatë, gjeti se gjykata e qarkut ka dhënë arsyetim të gjerë mbi gjetjet faktike të saj. Me këtë, gjykata e qarkut po ashtu analizoi në tërësi të gjitha provat e paraqitura në gjykatë. Edhe pse njëra nga palët mund edhe të mos pajtohet me përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, kjo nuk e bën arsyetimin e aktgjyqimit të paqenë.

Si pikë të dytë, mbrojtja pretendon në shkelje të procedurës penale sepse gjykata e qarkut, duke refuzuar propozimin e paraqitur nga mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka bërë inspektimin e vendngjarjes apo rikonstruktimin e ngjarjeve. Mbi këtë pikë Gjykata Supreme vëren se sipas Nenit 254 të KPPK-së gjykata mund të vendosë të bëjë rikonstruktimin por nuk obligohet të bëjë këtë edhe pse mbrojtja ka paraqitur një propozim të tillë. Ky veprim nuk është mandator. Në lëndën në fjalë, koha e gjatë që ka kaluar në mes krimit dhe shqyrtimit gjyqësor vërtetë e ka vështirësuar qartësimin e ngjarjeve duke bërë inspektim të vendngjarjes apo rikonstruktim. Sidoqoftë, nuk ka shenja se gjykata e qarkut ka tejkaluar kufijtë e lirisë së veprimit me refuzimin e rikonstruktimit.

Si pikë të tretë, mbrojtja kundërshton përmbajtjen e dispozitivit të aktgjyqimit të gjykatës së qarkut. Në veçanti mbrojtja gjen se dispozitivi është në kundërshtim me gjetjet faktike lidhur me armën e vrasjes. Gjykata Supreme konsideron se kjo arsye për ankesë është plotësisht pa meritë. Kolegji gjeti se të dy versionet e aktgjyqimit të kundërshtuar, ai në

Anglisht dhe në gjuhën Shqipe, janë shumë të qarta në dispozitiv kur thotë se krimi ishte kryer duke përdorur një armë. Përkitazi më këtë dispozitivi është tërësisht në përputhje me pjesën tjetër të aktgjykimit. Prandaj në aktgjykimin e kundërshtuar në këtë pikë nuk është konstatuar asnjë shkelje e procedurës.

Si pikë të katërt, mbrojtja ka ngritur dyshime për pranueshmërinë e dëshmive të dhëna nga Avni Osmani në polici më 29 tetor 2004, 30 tetor 2004 dhe 3 nëntor 2004 gjatë kohës kur ai nuk përfaqësohej nga avokatë mbrojtës. Nga procesverbalet e këtyre marrjeve në pyetje duket qartë se i pandehuri ishte i njoftuar me kohë për pozitën e tij si i dyshuar për krimin e vrasjes dhe se ishte i njoftuar për të drejtat e tij si i dyshuar, përfshirë të drejtën për të pasur këshilltar ligjor të pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Gjykata e shkallës së parë iu referua këtyre pyetjeve vetëm për të ilustruar versionet e ndryshme të ngjarjeve të dhëna nga Avni Osmani. Marrjet në pyetje si të tilla nuk ishin përdorur në pjesën e arsyetimit as në dobi e as në dëm të Avni Osmanit. Prandaj edhe kjo arsye për ankesë konsiderohet si e pabazë.

Si pikë të pestë dhe të fundit, pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ishte bërë asnjë vlerësim të duhur të besueshmërisë së provave kundërtënëse. Mbrojtja theksoi se asnjëherë gjatë gjykimit nuk është prezantuar procesverbali i raportit mjekoligjor mbi gjurmët e mundshme të barutit të armës të marra nga i pandehuri pas arrestimit të tij. Kjo pikë po ashtu është e pabazuar. Është evidente se një raport i tillë mjekoligjor nuk është përfshirë në shkresa të lëndës. Përveç kësaj nuk kontestohet se ky raport nuk është prezantuar asnjëherë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për këtë arsye nuk ishte e mundur që gjykata e shkallës së parë të vlerësojë këtë provë as në dobi e as në dëm të të pandehurit. Prandaj asnjë shkelje e procedurës penale nuk është konstatuar në aktgjykimin e ankimuar në këtë pikë.


2) Shkelja e ligjit penal. Mbrojtja fakton se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka asnjë arsyetim sa i përket qëllimit të të pandehurit për të vrarë viktimën dhe motivit të tij për kryerjen e veprës penale. Sa i përket elementit subjektiv (*mens rea*) të veprës penale, Gjykata Supreme gjen se – përkundrazi nga ajo çka pretendon mbrojtja – gjykata e

qarkut kishte vërtetuar drejt qëllimin dhe lidhjen shkakore në mes veprimeve të të pandehurit dhe vdekjes së viktimës. Në dispozitiv qartë thuhet se Avni Osmani me dashje ka privuar Kastriot Zogianin nga jeta e tij duke e qëlluar atë 12 herë në trup dhe që shprehimisht tregon qëllimin kriminal. Në lidhje me motivin, Gjykata Supreme tërheq vëmendjen se në përgjithësi nuk është madje e domosdoshme të vërtetohet motivi specifik për veprën penale. Në këtë rast motivi i tillë megjithatë ishte vërtetuar nga gjykata e qarkut sepse motivi ishte madje i lidhur si një nga dy rrethanat rënduese të veprës penale, siç ishte përfunduar nga gjykata e qarkut.

3) Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike. Ankesat pohojnë se Avni Osmani nuk është fajtor për vrasjen e Kastriot Zogianit. Mbrojtja fakton se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në mënyrën se si ka vlerësuar dhe shpallur përmbajtjet e dëshmive të dëshmitarëve dhe të pandehurve. Sa i përket kësaj arsyeje për ankesë Gjykata Supreme nuk u pajtua me vlerësimin e bërë nga mbrojtja. Pas vlerësimit me kujdes të provave në shkresa të lëndës dhe krahasimit të tyre me gjetjet faktike të aktgjyqimit të ankimuar, Gjykata Supreme ka arritur në përfundim se gjykata e qarkut ka bërë një vlerësim plotësisht të arsyeshëm të provave. Me vërtetimin e fajësisë së Avni Osmanit përtej dyshimit të arsyeshëm gjykata e qarkut ka marrë parasysh efektin grumbullues të provave të ndryshme dhe Gjykata Supreme në aktgjykimin e ankimuar nuk gjen asnjë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

4) Në fund, mbrojtja si dhe prokuroria kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës së qarkut mbi dënimin. Sa i përket dënimit, Gjykata Supreme pohon se kohëzgjatja e dënimit me burgim e shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë është e duhur në krahasim me dënimet e shqiptuara nga gjykatat e Kosovës për veprat penale të ngjashme me këtë vepër.

Për arsyet e përmendura më lart është vendosur si në dispozitiv.



Ap.-Kž. Nr. 364/2010

Sot më 12 prill 2011.

E përgatitur në gjuhën Angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Kolegjit

Lars Dahlstedt

Anëtar i Kolegjit

Charles L. Smith III

Anëtare e Kolegjit

Nesrin Lushta

Anëtar i Kolegjit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Martti Härsia
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE
Anëtare e Kolegjit
Punëtori i autorizuar
Kolegji i radnik
Emine Mustafa

Mjeti Juridik: Kundër këtij Aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Prishtinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit (Nenet 398, 407 dhe 430 të KPPK-së).

